

Teuta SHALA-PELI

Fjalë përshëndetëse

Kam nderin t'ju përshëndes dhe t'ju uroj mirëseardhjen në këtë konferencë të organizuar në bashkëpunim nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Instituti i Historisë “Ali Hadri”.

Organizimi i kësaj konference është një nga rezultatet konkrete të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Autoritetin për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, të cilën e vlerësojmë si një mundësi të rëndësishme për bashkëpunim të mëtejshëm institucional dhe shkencor. Shpresojmë që kjo marrëveshje të jetë vetëm fillimi i një bashkëpunimi afatgjatë dhe që në të ardhmen të realizojmë edhe projekte të tjera të përbashkëta, konferenca, hulumtime dhe botime shkencore.

Tema që trajtojmë sot është e rëndësishme jo vetëm për nga dimensionin politik dhe historik, por edhe për nga dimensionin njerëzor. Kufiri Shqipëri-Kosovë gjatë viteve 1944-1991 nuk ishte thjesht një vijë ndarëse mes dy shteteve dhe sistemeve politike. Për shumë njerëz, ai përfaqësonte ndarjen nga familja, nga të afërmit dhe nga një pjesë e rëndësishme e jetës së tyre.

Pikërisht për këtë arsye, dokumentimi i këtyre përvojave dhe hulumtimi i dokumenteve të kohës kanë një rëndësi të veçantë. Ato na ndihmojnë të kuptojmë më mirë të kaluarën dhe, njëkohësisht, t'ua përcjellim brezave të rinj një histori të mbështetur në fakte, dokumente dhe dëshmi.

Besoj se kumtesat, diskutimet dhe shkëmbimi i përvojave në këtë konferencë do të sjellin këndvështrime të reja dhe do të kontribuojnë në pasurimin e mëtejshëm të historiografisë shqiptare.

Në fund, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për të gjitha institucionet, studiuesit dhe bashkëpunëtorët që kanë kontribuar në realizimin e kësaj konference.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe ju uroj punime të frytshme, diskutime të suksesshme dhe një bashkëpunim sa më të mirë në të ardhmen!